



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:105826
Datë: 14.10.2024
Numri i dokumentit: 06293576

CAP.nr.416/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Lumni Sallauka, në çështjen juridike përmbartimore të kreditores Sh.H, të cilën e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “K & A” me seli në P..., ndaj debitorit të përmbartimit: Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, për shkak të borxhit në emër të shpërblimit jubilar, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.544/2023, të datës 09.01.2024, me datën **10.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës - Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, **PRISHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Cpc.nr.544/2023, i datës 09.01.2024, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktvendimin e atakuar, Cpc.nr.544/2023, të datës 09.01.2024, ka vendosur si në vijim: *“REFUZHET prapësimi i debitorit të përmbartimit, Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, i ushtruar kundër Aktvendimit Cpc.nr.544/2023, të datës 30.11.2023, mbi caktimin e përmbartimit, SI I PABAZUAR”*.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e debitorit, ndërsa aktvendimin e atakuar Cpc.nr.544/2023, të datës 09.01.2024, të e anulojë si të pabazuar, të pas afatshëm dhe të palejueshëm, pasi që në bazë të nenit 391 të LPK-së kemi të bëjmë me çështje që është e gjykuar (res judicata).

Përgjigje në ankesë ka parashtruar kreditori, me propozim që ankesa e debitorit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktvendimi i atakuar Cpc.nr.544/2023, i datës 09.01.2024, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 lidhur me 194 të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

- Ankesa e debitorit **është e themeltë**.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 05.05.2023, ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit kundër debitorit Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës – Qendra Klinike Universitare e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin Cpc.nr.544/23, të datës 30.10.2023, e ka lejuar ekzekutimin në bazë të dokumentit përmbartimor vendimit të Inspektoratit të Punës nr.21-1715/94, datë 10.02.2020 dhe vendimit për korrigjimin e gabimeve nr.01/21-1178, të datës 18.11.2020, të plotfuqishëm dhe të ekzekutueshëm, me bazë juridike kompensimi i pagave në emër të shpërblimit jubilar në shumë prej 607.27 euro, si dhe shumë 156 euro në emër të shpenzimeve të procedurës përmbartimore dhe taksën gjyqësore prej 20 euro, të paraparë më gjerësisht si në propozimin për përmbartim.

Kundër aktvendimit për lejimin e përmbartimit Cpc.nr.544/23, të datës 30.10.2023, debitori me datën 23.11.2023, ka ushtruar prapësim, ndërsa kreditori me datën 07.12.2023, ka ushtruar përgjigje në prapësim. Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin Cpc.nr.544/2023, të datës 09.01.2024, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe e ka vërtetuar urdhrin përmbartimor.

Gjykata e Apelit e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes, vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës shkallës së parë rreth mënyrës së vendosjes, nuk është i drejtë dhe i ligjshëm, ngase aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) të LPK, si dhe nuk është në përputhje me kërkesat ligjore që rrjedhin nga neni 160 i LPK-së, pasi që dispozitivi i aktvendimit të atakuar është i pakuptueshëm, i pa ekzaminueshëm, kontradiktor me vetveten dhe arsyet e dhëna, për më tepër që edhe ato arsye të cilat janë dhënë, janë në kundërshtim me vetë dispozitivin dhe provat shkresore të lëndës.

Pretendimin e debitorit në ankesë se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes për prapësimin e debitorit nuk ka marrë për bazë provat e bashkangjitura prej të cilave provohet se kreditorja Shpresa Halimi të njëjtën kërkesë e ka realizuar përmes procedurës përmbartimore P.nr.246/20, të datës 04.07.2020 dhe faktin se debitori ka përmbushur në tërësi detyrimin që ka rrjedhë nga kjo procedurë duke bërë pagesën e pagave jubilarë për kreditoren, Gjykata e Apelit e vlerëson si pretendim të bazuar. Kjo sepse referuar shkesave të lëndës, rezulton se debitori këtë pretendim e ka parashtruar edhe përmes prapësimit të datës 23.11.2023, ndërsa gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit të atakuar me të cilin ka vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, nuk ka vlerësuar dhe nuk ka dhënë fare arsyetim për këtë pretendim. Për më tepër, duke qenë se në shkresat e lëndës gjendet Urdhri P.nr.264/2020, i datës 04.07.2022, i lëshuar nga

përmbaruesi Privat I. I. K, sipas të cilit është përfunduar procedura përmbarimore për shkak të përmbushjes së kredisë, në lëndën përmbarimore të kreditores Shpresa Halimi kundër debitorit SHSKUK dhe meqë palët në procedurën përmbarimore që ka qenë objekt shqyrtimi në rastin konkret janë të njëjta, atëherë sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë është dashur të konstatoj lidhshmërinë mes këtyre dy procedurave, konkretisht faktin nëse kemi të bëjmë me të njëjtin borxh dhe pastaj të vlerësoj prapësimin e debitorit.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që t'i evitohet dhe sqarohet të gjitha paqartësitë lidhur me pretendimin e debitorit për përfundimin e procedurës përmbarimore dhe përmbushjen e borxhit ndaj kreditores i cili ka qenë objekti shqyrtimi në këtë procedurë përmbarimore, andaj gjykata e shkallës së parë mund ta udhëzojë palën përkatëse në kuptim të veprimeve procedurale të cilat ajo palë mund apo duhet t'i kryejë, për sqarimin e urdhrimit për përfundimin e procedurës përmbarimore i cili gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë që e njëjta pastaj duke aplikuar drejtë normat e të drejtës materiale, të ketë mundësi që të bëjë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Mbi bazën e shkeljeve të konstatuara si më lartë, kjo gjykatë gjeti se aktvendimi i ankimuar duhet prishur dhe çështja duhet kthyer në rivendosje tek gjykata e shkallës së parë, pasi që në rastin konkret nuk ka pasur kushte që i njëjti aktvendim të mund të ndryshohej nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Nga sa u tha më lartë dhe në mbështetje të nenit 208 dhe 209 pika (d) të LPK, lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CAP.nr.416/2024, datë 10.10.2024

Gjyqtari,
Lumni Sallauka